



ZYRA E KRYETARIT
KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Nr.Prot.	02/2023
Për:	Kryesuesin e Kuvendit të Komunës së Suharekës- z. Bexhet KUÇI
Nga:	Kryetari i Komunës në Suharekës, njëherit Kryesues i KKSB-së
Lënda:	Informatë për aktivitet e KKSB-së, për 6 mujorin e dytë të vitit 2023
Datë:	05.01.2024

Nga takimet e Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive (KKSB), në Komunën e Suharekës, të paraparë sipas Udhëzimit Administrativ të nënshkruar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal 27/2012, MPB dhe 03/2012, MAPL për themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi KKSB, ju dërgojmë këtë:

I N F O R M A T Ë

Pas konstituimit të organeve të Komunës në Suharekë, të daluar nga zgjedhjet lokale të vitit 2021, Kuvendi i Komunës në muajin janar të vitit 2022, ka themeluar Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB-në), konform Ligjeve dhe akteve tjera nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës, si organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi me përfaqësim të gjerë të të gjitha komuniteteve dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB-ja) për periudhën **korrik-dhjetor të vitit 2023**, ka mbajtur tri (3) takime të rregullta dhe ato konform planit të veprimit të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Suharekës.

Në këto takime kanë marrë pjesë kryesisht shumica e anëtarëve të Këshillit të (KKSB-së).

Në takimin e katërt (4) të rregullt të mbajtur me datën 16.08.2023, tema diskutimi kanë qenë:

- **Trajtimi i mbrojtjeve të pyjeve nga dëmtuesit ilegal;**
- **Informatë për fillimin e procesit mësikor dhe çështja e sigurisë nëpër shkolla;**
- **Informatë dhe analizë nga policia e Suharekës për çështjen e vjedhjeve dhe sigurisë së përgjithshme;**
- **Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta;**

Gjendja e pyjeve është më mirë se çdo herë tjetër. Komuna Suharekës ka 16.000 ha me pyje, 43 % pyje private, gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2023 janë bërë 45

fletëparaqitje për kundërvajtje të cilat i kemi dërguar në gjykatë në bashkëpunim me policinë kemi konfiskuar masa të ndryshme drusore dhe kemi pasur 5 raste me arrestim të dëmtuesve ilegal.

Nga fillimi i vitit 2024 Komuna nuk ka përgjegjësi të pyjeve sepse tani ky sektor kalon nën menaxhimin e Agjencionit pyjor të Kosovës

Si konkluzione apo rekomandim nga ky takim ka dalë që: Të mbahet takim në mes të Drejtorisë së Bujqësisë dhe policisë dhe USAID për vendosjen e kamerave në fshatin Mushtisht.

Të gjitha shkollat kanë qenë të hapura nga stafi për shërbime të ndryshme administrative gjatë gjithë sezonës verore. Po punojmë në përmirësimin e kushteve higjieno-teknike. Procesi do të filloj normalisht. Ne jemi gati për fillimin e vitit shkollor. Në secilën shkollë kemi krijuar nga një këshillë të sigurisë, dhe po ashtu kemi krijuar këshill për fëmijët me nevoja të veçanta.

Si konkluzione apo rekomandim nga ky takim ka dalë që: bashkëpunimi nxënës-shkollë-prind dhe mësimitdhënës të jetë edhe më i lartë si dhe Monitorim nga policia për shfrytëzimin e vendkalimit në Shirokë.

Për të parë një gjendje të sigurisë mund t'u them që në disa vepra kryesore dhe serioze që shqetësojnë qytetarët dhe në si organ i sigurisë siç janë vjedhjet e rënda dhe vjedhjet kemi një rënie nga viti në vit por në këtë vit numri i rasteve të përgjithshme ka rënë -10 % dhe me një zbulueshmëri të kënaqshme të këtyre rasteve sidomos të vjedhjeve të rënda.

Kryesisht gjatë kësaj periudhe jemi marruar me së shumti me çështjen e sigurisë sa më të mirë për qytetarët dhe për sigurinë e nxënësve për rrethe shkollave dhe vendeve ku dyshohet për dukurit negative.

Policia e stacionit të Suharekës kanë qenë të angazhuar në Veriun e Kosovës me 40% të stafit dhe po ashtu jemi të angazhuar në zbulimin e veprave penale.

Si konkluzione apo rekomandim nga ky takim, ka dalur: që të rritet edhe më shumë bashkëpunimi i policisë me qytetarët për të parandaluar dhe zbuluar autorët e vjedhjeve si dhe për çështje të komunikacionit, të merren masa më rigorozë ndaj shkelësve të rregullave por gjithmonë brenda suazave të ligjeve ekzistuese.

Është kategori e respektuar e shoqërisë në çdo takim. Komuna e Suharekës radhitet e para në krijimin e kushteve për këto kategori dhe përpos sigurimit për qasjen e personave me nevoja të veçanta në objektet institucionale edhe në vendet me të frekuentuar janë krijuar kushtet, Komuna ndan çdo vit mjete financiare për ti ndihmuar këtë kategori.

Si konkluzione apo rekomandim nga ky takim, ka dalur: Komuna të vazhdojë të jep maksimumin për këto kategori të merren parasysh të gjitha kërkesat nga këta persona me nevoja të veçanta.

Në takimin e pestë (5) të rregullt të mbajtur me datën 13.10.2023, tema diskutimi kanë qenë:

➤ **Raportimi për sigurinë në trafik;**

- **Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje;**
- **Informatë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike lidhur me mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve për sezonin e dimrit;**

Për sigurinë në trafik mendojë se duhet me dhënë kontribut secili anëtar i KKSB-së në lokacionet ku vijnë dhe këshillat e fshatrave sepse po kemi aksidente në zona rurale sa i përket raportimit për sigurinë në trafik në Komunën e Suharekës gjatë vitit 2023 sipas raportit 9 mujor kemi shtim të numrit të aksidenteve të trafikut ku fatmirësisht nuk kemi pas asnjë aksident me fatalitet. Aksidente me lëndime - 172; Aksidente me dëme materiale në rrugët magjistrale- 34; Aksidente me dëme materiale të cilat i ka menaxhuar stacioni policor në Suharekë - 230; Policia e Kosovës vetëm gjatë 9 mujorit të vitit 2023 ka bërë shtim të patrullimit me veturë nga 1940 në 1989; Patrullime me këmbë nga 1242 në 1293; Pika kontrolli nga 2066 në 2133; Tiketa të shqiptuara -6082.

Policia e Kosovës gjatë 9 mujorit e ka bërë konfiskimin e 58 patën shoferëve dhe ka lëshuar masë nga tre muaj deri një vit ndalesë për shoferët të cilët kanë bërë shkeljen e ligjit.

Konkluzioni i radhës nga ky takim ka qenë: Policia e Kosovës të marrin aksione më të shpeshta në matjen e shpejtësisë së automjeteve si dhe të bëjnë kontrolla të vazhdueshme në qytetin e Suharekës, me qëllim të zhbllokimit të trotuareve nga parkimet e automjeteve, në vendet e pa lejuar për parking.

Sa i përket informatave të dhunës në familje për këtë nëntëmuajor të këtij viti, kemi rënie të lehtë sa i përket dhunës në familje. Vitin e kaluar ka qenë ngritje shumë e madhe dhe shqetësuese të rastet e dhunës në familje. Faktorët kryesor që kanë ndikuar në rritjen e dhunës në familje kanë qenë rastet recidiviste.

Në raportin nëntë mujor të Policisë rastet e dhunës në familje në nëntë mujorin e parë: krahasuar me vitin e kaluar kemi rënie prej 12%, raste 57 në vitin 2022 ndërsa 45 raste në vitin 2023. Prej tyre 27 raste kanë shkuar në ndalim policor.

Me procedure të rregullt kanë shkuar 18 raste. Viktima femra kanë qenë 42 raste dhe një e mitur; Të dyshuara femra kanë qenë 4 raste; Të dyshuar meshkuj 42 raste; Viktima meshkuj 4, prej tyre 2 të mitur;

Raste në periferi 28; Raste në qendër 17; Viktima të mitur 3 raste; Raste të përsëritura 13. Ne e kemi mekanizmin kundër dhunës në familje të udhëhequr nga përfaqësues të Komunës i cili është shumë aktiv dhe mbajmë takime të rregullta. Gjithashtu mbajmë edhe ligjërata kundër dhunës në familje nëpër shkolla në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit.

Konkluzione apo rekomandim nga ky takim ka dalë: që të organizohet një tryezë dhe të diskutohet me mekanizmat kryesorë, që të merren masa adekuate për parandalimin e dhunës në familje.

Komuna është përgatitur për të ju dalur në ndihëm qytetareve sa i përket sezonit të dimrit, ne kemi kontraktuar firmën për pastrimin e rrugëve dhe trotuareve nga bora, e cila firmë ka për obligim që të jetë në dispozicioni e qytetarëve 24 orë, jemi të gatshëm të ju përgjigjem çdo kërkesë të qytetarëve për pastrimin e rrugëve dhe trotuareve aty ku është interesi i përgjithshëm i qytetarëve.

Konkluzione apo rekomandim nga ky takim ka dalë: që për pos mirëmbajtjeve të rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit të dimrit të bëhet mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve edhe gjatë sezonit të verës në tërë territorin e Komunës së Suharekës.

Në takimin e gjashtë (6) të rregullt të mbajtur me datën 19.12.2023, tema diskutimi kanë qenë:

- **Vetëdijesimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike;**
- **Identifikimi i vendeve ku dyshohet se të rinjtë tonë përdorin substanca narkotike;**
- **Masat për parandalimin e lëmshë-kërkuesve;**

Konkluzion apo rekomandim nga ky takim ka dalë: që komuna të dal me një komunikatë për mediat për sqarimin dhe rrezikun që paraqesin mjetet piroteknike si dhe kohën e shitjes dhe përdorimit të tyre dhe se prej cilës moshë lejohet t'u shiten mjete piroteknike.

Dhe nga data 23.12.2023 deri më 03.01.2024 të lejohet shitja e mjeteve piroteknike dhe lokacioni caktohet të tregu javor.

Sipas të dhënave Policia e Kosovës është e përkushtuar në eliminimin e dukurive negative sidomos të personave që merren me substanca narkotike e me thekës të veçantë të rinjtë. Sa i përket shkollave, ka përmirësim, gjithë ashtu vendosja e kamerave ka ndikuar që ne të kemi më pak punë dhe të ndiqen dhe të zbulohen personat e dyshimtë.

Unë si kryetar i Komunës nuk jam i kënaqur me këtë gjendje sepse e kam përgjegjësi dhe obligim ndaj gjithë qytetarëve porë çështja e sigurisë nuk është në dorën time. Ne i kemi dhënë të gjitha sallat sportive që i kemi në qytet dhe nëpër fshatra në mënyrë që ti largojmë fëmijët tonë nga dukuritë negative dhe ti orientojmë nga sporti dhe kultura.

Gjithashtu konkluzion tjetër apo rekomandim nga ky takim ka dalë: që të rritet edhe më shumë bashkëpunimi i policisë me qytetarët dhe Policia me rroba civile të frekuentojnë vendet ku dyshohet se të rinjtë po veprojnë në përdorimin e substancave narkotike.

Problemi i lëmshë-kërkuesve është problem dhe shqetësuese për të gjithë Kosovën. Këta vijnë si tranzit tek ne, ne i përcjellim dhe i dëbojmë në vendin nga kanë ardhur. Ata nuk janë lypës të Komunës sonë, janë nga Prishtina, Drenica si dhe vendeve tjera dhe shumica janë pa dokumente identifikimi ka edhe nga Shqipëria.

Me respekt!

Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ